

Mbështetur nga
Vodafone



FËMIJË TË SIGURTË NË INTERNET

Këshilla për prindër dhe mësues



Përmbajtja

- Hyrje
- Fëmijët dhe interneti?
- Rreziqet potenciale nga përdorimi i internetit
 1. Cyber bullying
 2. Takimi me njerëz të panjohur
 3. Ekspozimi ndaj përmbajtjes pornografike
 4. Lojrat online
 5. Publikimi dhe keqpërdorimi i të dhënave personale
- Rrjetet sociale
- Mbrojtja ligjore dhe interneti
- Të dhëna për sigurinë online në Shqipëri
- Si mund ti ndihmojmë fëmijët për një qasje të sigurt në internet?
 - Ofruesit e Shërbimit të Internetit (ISP)
- Këshilla për prindërit dhe mësuesit

A close-up photograph of a child's hand with blonde hair, wearing a pink shirt, placing colorful wooden letters on a white surface. The letters spell out 'COMI'. The 'C' is yellow with red spots, the 'O' is blue with white polka dots, and the 'M' is yellow with red spots. The child's hand is positioned to place the final letter, 'I', which is also yellow with red spots. The background is a plain white wall.

COMI

Hyrje

Zhvillimet e shpejta të teknologjisë, pajisja e fëmijëve me smartphonë, mbulimi gjithnjë e më tepër i hapësirave urbane me wireless e kanë përhapur shumë përdorimin e internetit nga fëmijët. Përveç vlerave shumë të mëdha të internetit, është me rëndësi të flitet hapur për rrezikun e përdorimit të internetit nga fëmijët. Për të rritur informimin dhe sensibilizimin e prindërve dhe mësuesve mbi internetin e sigurt, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve ka ndërmarrë iniciativën për të publikuar dhe shpërndarë një broshurë për prindër dhe mësues, lidhur me sigurinë e fëmijëve në internet.

Botimi i materialit është mbështetur nga kompania Vodafone Albania. Në hartimin e kësaj broshure jemi bazuar në materialin e prodhuar nga Qendra për Edukim e Kosovës (FIT), duke e përshtatur në kontekstin Shqiptar. Nëpërmjet kësaj broshure synojmë t'ju ofrojmë këshilla dhe udhëzime lidhur me internetin dhe sjelljen e fëmijëve në internet. Materiali do ndihmojë prindërit dhe mësuesit për rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e fëmijëve në internet.

Qëllimi i kësaj broshure është:

- Të informojë prindërit dhe mësuesit se për çfarë e përdorin fëmijët internetin
- Cilat janë rreziqet potenciale për fëmijët gjatë përdorimit të internetit
- Çfarë roli duhet të luajnë prindërit dhe mësuesit për t'i mbajtur fëmijët të sigurt në internet
- Si të mbajmë fëmijët të sigurt gjatë përdorimit të internetit.



Fëmijët dhe Interneti

Interneti ofron mundësi shumë të mira për fëmijët, për të mësuar gjëra të reja që lidhen me interesat e tyre të përgjithshme, dëshirat, apo detyrat shkollore. Grupmosha të ndryshme përdorin internetin në mënyra të ndryshme, si për tu argëtuar, për të dëgjuar muzikë, për të luajtur lojëra, për të parë filma, apo për të komunikuar me miqtë. Më poshtë kemi paraqitur aktivitetet kryesore në internet sipas grupmoshave si në vijim:

Mosha 2- 6 vjet

Fëmijët që nga mosha pesë vjeçare mund të fillojnë të vizitojnë faqet e internetit për fëmijë, por ata gjithmonë do të duhet të jenë të shoqëruar nga prindërit. Preferohet që fëmijët e kësaj moshe të kalojnë sa më shumë kohë me moshatarët e tyre dhe larg nga ekranet digjitale. Gjithsesi, shumë prindër mund të gjejnë përmbajtje interesante që mund të zgjojnë kureshtjen e fëmijëve të tyre. Video të ndryshme në Youtube mund t'ju shërbejnë prindërve për t'ju mësuar fëmijëve këngë apo për t'i argëtuar ata. Prindërit duhet të kenë kujdes që fëmijët në këtë moshë të mos argëtohen vetëm nëpërmjet përdorimit të telefonit apo kompjuterit, por të zhvillojnë dhe lojëra interaktive në mënyrë që fëmija të zhvillohet sa më shëndetshëm.

Mosha 7-11 vjet

Kjo grup moshë është më problematike për t'u menaxhuar për shkak se fëmijët janë mjaft të vetëdijshëm për përdorimin e internetit dhe mundësitë që ofron, por nuk janë të vetëdijshëm për rreziqet online. Edhe nëse prindërit u tregojnë rreth rreziqeve ata e kanë të vështirë t'i kuptojnë rreziqet. Disa fëmijë në këtë moshë mund të fillojnë të përdorin internetin për të kërkuar materiale të papërshtatshme për moshën e tyre. Aftësitë dhe pavarësia e tyre do të vazhdojnë të rriten, por duke bërë kërkime në internet si një aktivitet i përbashkët familjar, u mundëson prindërve për të ruajtur dhe mbikëqyr nga afër fëmijët e tyre.



Mosha 12-18 vjet

Në këtë moshë të adoleshencës, interneti bëhet një mjet i rëndësishëm në jetën e tyre. Ata fillojnë të përdorin internetin për të kërkuar material për detyrat e shkollës dhe projektet e ndryshme. Në të njëjtën kohë, adoleshentët fillojnë të bëhen më të pavarur dhe kanë më shumë vetëbesim dhe gjithnjë e më shumë duan liri. Shumica e fëmijëve në këtë moshë kanë krijuar profilin e tyre në internet përmes rrjeteve sociale. Disa adoleshentë bëjnë përpjekje për të hyrë në faqe të internetit që kanë material të papërshtatshëm. Shumë adoleshentë më të rritur mund të fillojnë të krijojnë programet e tyre dhe e dinë se si të menaxhojnë pajisjet digjitale shumë më mirë sesa vetë prindërit. Këto shkathtësi dhe njohuri të tyre mund të sjellin ngjarje të pakëndshme nëse ata nuk janë të informuar për rreziqet që mund të shfaqen në internet.

Rreziqet nga përdorimi i internetit



Zhvillimi i teknologjisë paraqet një sfidë për gjithë shoqërinë, posaçërisht për fëmijët dhe të rinjtë. Sa më shumë që fëmijët fillojnë të përdorin internetin dhe pajisjet e teknologjisë informative, ata duhet edhe të rrisin njohuritë për përdorimin e këtyre pajisjeve dhe njohuritë për rreziqet që vijnë nga përdorimi jo i sigurt i internetit. Rreziqet për fëmijët gjatë përdorimit të internetit mund të jenë të shumta, në varësi nga mosha, faza e zhvillimit dhe mënyra se si lidhen në internet. Prindërit dhe mësuesit kanë përgjegjësi të veçantë për mbrojtjen e fëmijëve. Në vijim do përmendim disa nga rreziqet më të shpeshta, mirëpo nuk përjashtohen edhe rreziqe të tjera që nuk janë përfshirë në këtë vëllim. Këto janë: ngacmimi virtual, takimi me njerëz të panjohur, ekspozimi ndaj përmbajtjes pornografike, lojrat online, si dhe keqpërdorimi i të dhënave personale. Në vijim do të gjeni disa nga rreziqet kryesore më të shpeshta që fëmijët hasin gjatë përdorimit të internetit dhe do të ofrojmë zgjidhje për raste të caktuara.

1. Ngacmimi virtual – cyber bullying

Cyber bullying është terminologji në gjuhën angleze që përdoret kur njerëzit përdorin internetin për të kërcënuar, ngacmuar, apo poshtëruar dikë duke dërguar mesazhe të këqija, fotografi dhe video tronditëse tek personat e panjohur. Ka shumë forma të cyber bullying, mirëpo këto janë më të shpeshtat:

- Dërgimi i e-mailave që mund të jenë kërcënuese apo shqetësuese (psh. mesazhe fyese, raciste apo paragjykime të tjera);
- Dërgimi ose postimi i thashethemeve të shokët apo direkt të viktimave;
- Postimet në rrjetet sociale - psh. i sekreteve të dikujt (p.sh. Facebook ose Twitter);
- Fyerja e fëmijëve duke ju vënë nofka apo pseudonime përmes mesazheve, komunikimit në chat, postimit në facebook, etj;
- Dërgimi ose postimi i fotografive të personave të tjerë, pa lejen e tyre (zakonisht fotografi turpëruese ose intime/personale) në internet.
- Krijimi i profileve apo webfaqeve të caktuara në internet, duke shënjestruar një individ apo grup të caktuar fëmijësh me qëllim talljeje apo fyerjeje.
- Është me rëndësi që nëse keni pranuar mesazhe me përmbajtje të tilla, asnjëherë mos ju përgjigjini, e vetmja gjë që duhet të bëni është të injoroni mesazhin dhe ta fshini menjëherë. Por në këto raste duhet patjetër të njoftoni një të rritur në familjen tuaj për këtë gjë që ata të gjejnë mënyra për t' ju ndihmuar.



Si të dalloni nëse fëmija është duke përjetuar ngacmim virtual (cyber bullying)?

Fëmijët të cilët ngacmohen online kanë pak a shumë të njëjtat simptoma apo mënyra të përballjes me problemet me të cilat ata ballafaqohen. Ju rekomandojmë që nëse vëreni disa nga sjelljet e mëposhtme tek fëmija juaj, të konsultoheni me të dhe të diskutoni problemet. Fëmijët që janë viktime të cyber bullying zakonisht:

- Ndihen të frikësuar, shqetësuar, pikëlluar, apo frustruar sa herë që përdorin internetin,
- Kanë doza të depresionit,
- Bien nga mësimet,
- Kalojnë shumë më pak kohë me shoqërinë,
- Fshehin aktivitetet e tyre online,
- Flasin në telefon më privatisht dhe shkëmbejnë mesazhe më shpesh,
- Flasin me ju për fëmijë të tjerë që janë viktime të cyberbulling,
- Nuk bëjnë gjumë të rregullt dhe i çrregullohet bioritmi.

Pasojat e cyber bulling

Viktimat e cyber bullying pësojnë të njëjtat efekte negative sikurse ngacmimi në jetën e përditshme, por shpesh efektet e

cyber bullying janë më të mëdha për shkak se mesazhet mund të bëhen publike dhe mund të shihen nga një audiencë e madhe e pa kufi. Rreziku më i madh vjen nga fakti se ky abuzim i filluar nëpërmjet internetit, shpesh nuk ndalet me aq, mirëpo mund të vazhdojë t'i ndjekë fëmijët edhe në jetën e përditshme duke i shqetësuar ata gjatë aktiviteteve ditore e duke ndikuar në jetën normale të tyre. Gjithashtu për shkak se interneti mundëson ruajtjen e informatave për kohë shumë të gjatë, mesazhet fyese ndaj fëmijëve mund të ruhen dhe t'i shqetësojnë fëmijët deri në moshë të rritur.

2. Takimi me njerëz të panjohur

Shqetësimi kryesor i prindërve dhe sa i përket sigurisë së fëmijëve në internet është takimi me njerëz të panjohur të cilët i kanë njohur përmes internetit. Kur qasja në internet dhe përdorimi i pakontrolluar i rrjeteve sociale ka bërë që fëmijët të jenë shumë të ekspozuar ndaj rreziqeve që vijnë nga njerëz të panjohur. Fëmija mund të takohet me persona shumë të rrezikshëm të cilët kanë për qëllim që të lëndojnë fëmijën tuaj në mënyra të ndryshme. Ka pasur raste kur fëmijët kanë përfunduar si viktime të trafikimit përmes komunikimit në rrjetet sociale me njerëz të panjohur. Fëmija juaj është i pambrojtur dhe mund të bjerë pre i shumë keqbërësve të cilët mund t'i vjedhin identitetin, ta ngacmojnë, të vjedhin adresën e tyre, etj. Kontakti me përdorues të panjohur kryesisht bëhet përmes mesazheve nëpër rrjete sociale.

Shenjat që fëmija është duke komunikuar me njerëz të panjohur online

- Kalon shumë kohë online në rrjete sociale
- Ka foto të njerëzve të panjohur në telefon apo në kompjuter
- Flet shpesh në telefon dhe nuk tregon për identitetin e bashkëbiseduesit
- Fëmija shpejt e ndryshon ose e fik monitorin e kompjuterit, kur ju afroheni
- Ndryshimet e dukshme në sjellje, duke përfshirë edhe rritjen e fshehtësisë ose vetëmbrojtjes
- Kalon më pak kohë se zakonisht me shokët apo shoqet
- Merr email nga dikush që ju nuk e njihni
- Merr dhurata nga persona të panjohur
- Shpenzon sasi të madhe të kohës online, sidomos gjatë natës
- Bëhet më i/e tërhequr nga familja

Pasoja të mundshme nga takimi me njerëz të panjohur:

- Dhuna fizike apo cyberdhuna ndaj fëmijës
- Keqpërdorimi i të dhënave personale
- Vjedhja e identitetit
- Keqtrajtimi fizik dhe kërcënimi
- Dhunimi seksual apo psikologjik

3. Ekspozimi ndaj përmbajtjes pornografike

Fëmijët lehtë mund të jenë të ekspozuar ndaj materialeve të paligjshme, shpeshherë edhe pa e kuptuar se janë të paligjshme dhe të dëmshme për moshën e tyre. Fëmijët shpeshherë hapin llogari të rreme me qëllim të hapjes së këtyre faqeve që janë të dedikuara për të rriturit. Për fat të

keq, shumë prindër nuk janë të informuar për t'u marrë me çështjet e sigurisë në internet dhe kanë nevojë për informacion. Mungesa e përvojës dhe sinçeriteti i pastër i fëmijëve mund t'i çojë ata drejt rreziqeve online. Fëmijët mund të hasin në përmbajtje pornografike rastësisht ose qëllimisht nga kurioziteti.

Disa nga shenjat që tregojnë se një fëmijë është duke parë pornografi online janë:

- Fëmija e ndryshon menjëherë ose e fik monitorin e kompjuterit, kur ju afroheni.
- Ndryshimet e dukshme në sjellje, duke përfshirë edhe rritjen e fshehtësisë ose vetëmbrojtjes.
- Ju gjeni pornografi në kompjuterin e fëmijës suaj.
- Gjetja e-mail-ve të papërshtatshme në kompjuterin tuaj.
- Fëmija juaj është duke përdorur një llogari online që i përket dikujt tjetër.
- Fëmija juaj bëhet i tërhequr nga familja.
- Fëmija juaj shpenzon sasi të madhe të kohës online, sidomos gjatë natës.
- Fëmija juaj merr telefonata nga njerëz të panjohur, ose bën thirrje, nganjëherë në distancë të gjatë, në numrat që ju nuk i njihni.
- Fëmija juaj merr e-mail nga dikush që ju nuk e njihni.
- Fëmija ka një kureshtje të pazakontë në lidhje me seksualitetin e moshës së tij.
- Fëmija tregon shenja të parakohshme të aktivitetit seksual.

Pasoja nga pornografia janë të shumta, pornografia ndikon:

- negativisht në shëndetin emocional dhe mendor të fëmijëve;
- promovon "mungesën e edukimit" seksual;
- mëson se "argëtimi i të rriturve" është normal dhe i dëshirueshëm;

- mund të shkaktojë devijime të aktivitetit bën të pandjeshëm shikuesit dhe rrit një oreks për lojet më të devijuara, të çuditshme, ose të dhunshme të pornografisë;
- ruan imazhe që nuk mund të fshihen asnjëherë;
- mund të çojë në rritjen e agresivitetit seksual

4. Lojrat online

Kur luani një lojë qoftë në internet apo të instaluar në kompjuterin tuaj, mund të përjetoni ndjesinë se patjetër duhet të fitoni apo kaloni në nivelin tjetër.

Është më rëndësi të kuptojmë se kjo është vetëm një lojë, një mënyrë argëtimi që ndonjëherë fitojmë dhe ndonjëherë humbim. Nuk ka asgjë të keqe nëse humbni, në disa raste kur pësoni humbje vetëm se bëheni më të shkathët pasi që keni filluar ta kuptoni strategjinë e lojës. Kur jeni duke luajtur në internet duhet të keni kujdes që kur jeni fitues apo humbës të mos e bezdisni apo fyeri dikë në internet që luan bashkë me ju.

Është mirë të përdorni një pseudonim apo shkurtesë të emrit tuaj kur ju jeni duke përdorur faqet e lojrave, në vend të emrit tuaj të vërtetë. Në rrjetin e lojrave ka njerëz nga e gjitha bota për të cilët ju nuk keni informata se kush janë. Kujdesi juaj gjatë kohës në internet duhet të jetë në nivelin e duhur.

Pasoja nga lojrat e dhunshme online:

- Lojërat mund të ndikojnë negativisht në shëndetin emocional dhe mendor të fëmijëve;
- Përdorimi i tepruar i internetit ndikon negativisht në shëndetin dhe zhvillimin social të fëmijëve. Qëndrimi për një kohë të gjatë para kompjuterit pa biseduar me dikë tjetër ndikon që fëmijët të bëhen më të mbyllur, të mos përmirësojnë aftësitë sociale të komunikimit; të humbin ndjenjën e komunitetit dhe të bëhen të izoluar;
- Disa video lojëra ndikojnë që fëmijët të bëhen agresivë në sjellje ose në mendime;

- Fëmija bëhet pasiv dhe mund të ketë problem me mbipeshën;
- Studiues të ndryshëm kanë gjetur se ka një lidhje ndërmjet depresionit dhe luajtjes së lojrave të dhunshme kompjuterike;
- Fëmijët që luajnë video-lojra shpesh bëhen të dhënë pas lojrave.

Shenjat që fëmija është duke kaluar më shumë kohë se duhet duke luajtur lojra online:

- Preokupimi pas kompjuterit ose pajisjeve të ngjashme elektronike;
- Minimizimi i shpejtë i përdorimit të kompjuterit;
- Shfaqja e mungesës së kontrollit;
- Humbja e kohës;
- Rezultate të dobëta në shkollë;
- Shfaqja e impakteve negative në fushat e tjera të jetës;
- Tërheqja (mbajtja në distancë);
- Keqpërdorimi i parave;

5. Publikimi dhe keqpërdorimi i të dhënave personale

Ka shumë mënyra që rrisin ekspozimin e fëmijëve ndaj rreziqeve në internet dhe njëri nga këta faktorë është publikimi i të dhënave personale të fëmijëve. Moskontrollimi i parametrave të privatësisë nëpër rrjete sociale apo adresa elektronike është shumë i rrezikshëm pasi persona të dytë mund të keqpërdorin të dhënat personale të fëmijëve.

Çfarë janë të dhënat personale? - Të gjitha informacionet që mund të identifikojnë personalitetin e fëmijës përmbajnë të dhëna personale. Emri, mbiemri, fotografia nga e cila mund të identifikohen, datëlindja, adresa, profesioni, numri i telefonit, IP adresa e kompjuterit, janë të gjitha të dhëna personale.

Si të vëreni nëse të dhënat e fëmijës janë në rrezik apo po keqpërdoren?

- Merrni e-mail nga fëmija me reklama apo virus të ndryshëm;
- Merrni ftesa nëpër rrjete sociale për të klikuar në faqe të ndryshme;
- Kompjuteri që e përdor fëmija ka vazhdimisht virus të ndryshëm;
- Shihni postime që nuk janë të fëmijës por kanë identitetin e tyre;



Rrjetet sociale

Rrjetet sociale janë bërë shumë të përhapura kohët e fundit duke mundësuar njerëzit të njihen më afër me miqtë, aktivitetet e tyre dhe të komunikojnë në çdo moment. Disa nga rrjetet sociale më të njohur janë Facebook dhe Twitter. Gjithkush mund të krijojë faqen personale me informacione për shkollën, muzikën dhe sportin e preferuar. Rrjetet sociale janë një dritare ku mund të shkruash mendimet e përditshme dhe të ftosh njerëzit të japin komentet e tyre.

Rrjetet sociale gjerësisht përdoren nga fëmijët. Ato mundësojnë fëmijët të postojnë muzikë, video, fotografi personale dhe të miqve. Por është shumë me rëndësi që t'i pyesim miqtë nëse ata na lejojnë që të postojmë në faqet e tyre, ndonjë nga fotografitë e miqve. Për të rritur numrin e shokëve dhe shoqëve, fëmijët mund të ftojnë miqtë për të pasur qasje në faqen e tyre dhe anasjelltas. Çdo informatë personale që shtohet në këto faqe mund të shihet nga kushdo në botë.

Kur hapni profilet tuaja në faqet e rrjeteve sociale, gjithmonë duhet të keni kujdes se çfarë informacioni përfshini në profilin tuaj. Të jeni të vetëdijshëm se informatat dhe fotografitë tuaja në profilin tuaj mund të shihen nga kushdo nëse nuk i rregulloni kontrollet e privatësisë. Pra, nëse ju nuk ndjeheni rehat me këtë fakt, atëherë me mirë të mos i publikoni ato në profilin tuaj dhe mos t'i bëni publike. Nëse nuk do dëshironit që një shkrim apo koment të shihet nga prindërit, familjarët, apo ndonjë person i caktuar, më mirë mos e postoni atë.

Kini kujdes, mbani mend:

- Sigurohuni që në profilin tuaj nuk keni vënë ndonjë informacion personal, siç janë numri juaj i telefonit, email, adresa personale, adresa e shtëpisë ose emri i shkollës tuaj.
- Nëse ju postoni diçka në profilet tuaja private në internet, (fjalë, foto, video), ju humbni kontrollin mbi atë informacion. Ky informacion mund të kopjohet dhe të postohet përsëri nga të tjerë.



- Pranoni kërkesa për shoqërim vetëm nga njerëzit që i njihni personalisht.
- Mëso për rregullat e privatësisë dhe përditësoni ato shpesh.
- Mos e tregoni vendndodhjen tuaj.

Si të vëreni nëse të dhënat e fëmijës janë në rrezik apo po keqpërdoren?

- Merrni e-mail nga fëmija me reklama apo virus të ndryshëm;
- Merrni ftesa nga fëmija nëpër rrjete sociale për të klikuar në faqe të ndryshme;
- Kompjuteri që përdor fëmija ka vazhdimisht viruse të ndryshëm;
- Shihni postime që nuk janë të fëmijës por kanë identitetin e tyre;

Këshilla që mund t' ju ofroni fëmijëve tuaj për mbrojtje më të mirë:

- Ata duhet të lexojnë me kujdes politikatat e privatësisë për faqet e internetit të cilat i përdorin;
- Inkurajoni që të publikojnë sa më pak detaje që i identifikojnë ata apo vendndodhjen e tyre;
- Të mos publikojnë online gjëra të cilat nuk dëshironi të jenë publike;
- Të mos e ndajnë adresën private të e-mail me njerëz që nuk i njohin dhe të mbajnë vetëm për vete fjalëkalimin;
- Gjatë regjistrimit apo plotësimit të formularëve të ndryshëm, të japin vetëm informatat e kërkuara që janë të shënuara me shenjën yll (*);
- Vërtetoni se një faqe interneti është e sigurt duke kërkuar shenjat identifikuese;

Mbrojtja ligjore dhe interneti

Çfarë është krimi kibernetik?

Krimi kibernetik lidhet me një aktivitet kriminal të zhvilluar në rrjet

(internet). Ekziston një numër i madh i rreziqeve potenciale që rrezikojnë privatësinë dhe sigurinë e përdoruesve të internetit dhe veçanërisht fëmijëve. Në epokën dixhitale, çdo fëmijë është vetëm një klik larg nga pornografia, abuzimi seksual, dhe kërcënimet e reja në botën Online. Për të garantuar sigurinë ligjore ndaj veprave penale në fushën e teknologjisë së informacionit, pjesë e Kodit Penal është edhe legjislacioni për krimin kibernetik. Në vitin 2002 shteti shqiptar ka ratifikuar Konventën “Për krimin në fushën e kibernetikës”.

Cilat janë veprimtaritë kriminale që zhvillohen në rrjet dhe më të cilat mund të përballen fëmijët?

- 1. Shpërndarja e qëllimshme e materialeve me përmbajtje raciste ose ksenofobie.**
- 2. Fyerja që mund t'i bëhet një personi për shkak të përkatësisë etnike, kombësisë, racës apo fesë.**
- 3. Kërcënimet për vrasje ose plagosje që bëhen nëpërmjet sistemeve kompjuterike.**
- 4. Propozimet e bëra nga një i rritur, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, për të takuar një të mitur me qëllim kryerjen e krimeve seksuale ose kryerjen e veprave penale kundër moralit dhe dinjitetit**
- 5. Pornografia në internet është një tjetër rrezik potencial për fëmijët. Ajo shfaqet nëpërmjet veprimtarive kriminale si:**
 - Përdorimit, shtrëngimit ose bindjen e një fëmije për të marrë pjesë në shfaqje pornografike.
 - Prodhimi, ofrimi, shpërndarjen, transmetimin, përdorimi ose posedimi i pornografisë së fëmijëve, si dhe krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme në të.
 - Shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja dhe botimi i materialeve pornografike në mjediset ku ka fëmijë me çdo mjet ose formë.

Çfarë duhet të bëjnë prindërit dhe mësuesit?

Është e rëndësishme që prindërit dhe mësuesit të dinë se ku të drejtohen në rast se fëmijët e tyre apo nxënësit gjatë përdorimit të internetit rrezikohen nga veprat kriminale të sipërpërmendura. Në Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe në Prokuroritë kryesore në vend është ngritur sektori i krimit kibernetik i cili në fokus të punës së tij ka hetimin e veprimtarive kriminale që zhvillohen në rrjet.

Legjislacioni është gjysma e punës, por pjesa tjetër i takon prindërve dhe mësuesve të cilët duhet të dinë se çfarë shikojnë fëmijët kur qëndrojnë në internet. Ata janë vija e parë e mbrojtjes kundër kërcënimeve online.

Të dhënat për sigurinë online në Shqipëri

Siguria e fëmijëve online është një çështje e re në Shqipëri që ka marrë një vëmendje vetëm vitet e fundit. Një studim që hecch dritë mbi fenomenin është realizuar në dhjetor 2013 - janar 2014 nga WorldVision. Për të arritur në gjetjet e studimit janë intervistuar **900 fëmijë** të moshës **13 - 18 vjeç** nga qytetet Tiranë, Korçë, Shkodër, Vlorë, Elbasan dhe Peshkopi nga ku **67%** e fëmijëve të intervistuar jetojnë në zonat rurale dhe **55%** e tyre janë vajza. Gjetjet e studimit tregojnë se rreth **85%** e të rinjve të intervistuar kanë një kompjuter në shtëpi. Tri janë pajisjet më kryesore që përdoren nga fëmijët shqiptarë, që i përkasin moshës **13 - 18 vjeç**:

- **telefonat celularë (65%),**
- **kompjuterat personalë (PC-të) (59%)**
- **dhe laptop-ët (43%).**

Ndryshe nga vende të tjera europiane, familjet shqiptare parapëlqejnë që t'i mbajnë kompjuterat në dhomat e fëmijëve. Nga studimi rezulton se rreth **62%** e fëmijëve që kanë akses në internet, kanë një kompjuter në dhomën e tyre të gjumit. Internet kafetë janë gjerësisht të aksesueshme si në zonat rurale dhe ato urbane.

44% e fëmijëve përdorin internetin për të shikuar material pornografik rregullisht;

45% e fëmijëve përballen me ngacmime, vjedhje të fjalëkalimeve, si dhe shikim të paqëllimshëm të materialeve pornografike gjatë përdorimit të internetit çdo ditë;

68% e fëmijëve konfirmojnë ekzistencën e kompjuterave, ose ekraneve që shfaqin materiale pornografike në kundërshtim me dëshirën e tyre.

Familjarët dhe miqtë janë personat e parë ku fëmijët raportojnë një problem ose kërkojnë ndihmë, ndërkohë që mësuesit dhe punonjësit e policisë janë figurat që ka më pak të ngjarë që fëmijët të drejtohen për ndihmë e të raportojnë.

27% e fëmijëve nuk e konsiderojnë policinë si një institucion për ndihmë.

32% e fëmijëve të intervistuar konfirmuan që nëse do të lëndoheshin online, më pak të mundshmit për t'iu kërkuar ndihmë do të ishin mësuesit.

Fëmijët e intervistuar raportojnë që janë kontaktuar online nga qytetarë të huaj të panjohur. Shumica e tyre janë nga **Mbretëria e Bashkuar (33%)**, **Italia (14%)** dhe nga **SHBA (8%)**. Rreth **47%** e fëmijëve të

intervistuar pranojnë që, brenda vitit të fundit, ata janë kontaktuar online nga një individ i panjohur.

Si mund ti ndihmojmë fëmijët për një qasje të sigurt në internet?

Ka disa mënyra se si prindërit dhe mësuesit mund të bllokojnë qasjen e fëmijëve nëpër webfaqe të cilat nuk janë të përshtatshme për fëmijët. Prindërit dhe mësuesit mund të instalojnë programe të cilat e bllokojnë automatikisht hyrjen në webfaqe të ndryshme pornografike, loja bixhozi, apo me përmbajtje të dhunshme. Shumica e prindërve i besojnë fëmijëve të tyre, por sidoqoftë fëmijët mund të ndeshin materiale shqetësuese. Filtrimi dhe moderimi janë mënyra të mira për të ndaluar përmbajtjen e papërshtatshme dhe të dëmshme. Këto ju mundësojnë të vendosni kufij online sipas moshës së fëmijëve. Ne rekomandojmë përdorimin e këtyre programeve jo vetëm në shtëpi, por edhe në shkollë.

Ka tri nivele kryesore për përdorimin e kontrolleve:

1. Internet Service Providers (ISP)

Internet Service Providers (ISP) si Albtelecom, Abcom, Abissnet, Tring Communication por edhe operatorët e komunikimit telefonik dhe online si TMobile, Vodafone Albania, Eagle Mobile, Plus, Shoqata Shqiptare e Teknologjisë së Informacionit (AITA) ofrojnë internet në shtëpitë tuaja. Këta ofruer shërbimi të internetit ofrojnë mundësinë e “filtrave mbrojtës” të cilat kufizojnë hyrjen në internet. Shpeshherë prindërit dhe mësuesit nuk kanë asnjë informacion apo nuk e dinë që ekzistojnë të tilla filtra mbrojtës. Po çfarë janë filtrat mbrojtës? Filtrat mbrojtës janë instrumenta teknike që përdoren për të mbrojtur fëmijët dhe të rinjtë nga aksesi në përmbajtje jo të dëshiruara ose të dëmshme në internet. Këto filtra mund të shkarkohen dhe instalohen pa pagesë nga interneti por edhe ofrohen falas, nga kompania nën kujdesin ndaj klientit. Gjithashtu, këto kompani kanë broshura që ofrojnë këshilla për kujdesin prindëror si për shembull për përdorimin e sigurt të telefonit celular, për lundrim të sigurt në faqet e internetit etj.



2. Mjetet me të cilat shfrytëzoni internetin:

Shumica e kompjuterave, telefonave celularë dhe pajisjeve të lojërave kanë edhe opsionin për kontroll prindëror. Për shembull sistemet operative windows dhe Mac kanë opsionin e kontrolleve që mund të aktivizohen në kompjuter.

3. Softweri

Ka një mori paketash që mund të blihen apo shkarkohen nga Interneti falas për këtë qëllim. Kontrollat prindërore nuk mund të bëjnë Internetin **100%** të sigurt dhe ju duhet po ashtu të bisedoni me fëmijët tuaj për përdorimin e sigurt të Internetit.

Çdo paketë për kontroll duhet të përmbajë këto shërbime:

- Filtrim të përmbajtjes për të ndaluar hyrjen në faqe të caktuara siç janë faqet pornografike;
- Kufizimet kohore për të kufizuar kohën gjatë së cilës fëmijët mund të përdorin internetin apo periudha kohore gjatë së cilave fëmijët mund të kenë qasje në faqe të caktuara;
- Monitorimi që ju informon rreth faqeve të cilat fëmijët tentojnë t'i vizitojnë;
- Raportimi që ju jep informata rreth faqeve që fëmija ka vizituar;

Këshilla për prindërit dhe mësuesit



Kjo pjesë e broshurës ka për qëllim të ofrojë këshilla të përgjithshme për prindërit dhe mësuesit se si ata duhet t'i mësojnë fëmijët të mbrohen gjatë përdorimit të internetit.

1. Mbani kompjuterin në ambiente të përbashkëta

Mbani kompjuterin në ambiente të përbashkëta dhe poziciononi monitorin e kompjuterit në atë mënyrë që të gjithë të kenë mundësi ta shohin gjatë përdorimit të internetit. Mundohuni të jeni sa më shumë të pranishëm në momentet kur fëmijët janë duke përdorur internetin, ose përdorini programet për "kontroll prindëror". Kujdes, sa më shumë që rriten fëmijët ata kërkojnë më shumë privatësi gjatë përdorimit të internetit. Këtë e arrijnë shpesh duke përdorur Laptop, apo pajisje të tjera teknologjike dhe rrjetin wireless. Në këtë rast është mjaft e vështirë për t'i monitoruar fëmijët gjatë përdorimit të internetit.

2. Bisedoni me fëmijët tuaj

Përdor kontaktet e përditshme me fëmijët për të biseduar lidhur me përdorimin e internetit. Mos prisni që ata të fillojnë bisedën edhe nëse ju jeni shumë të afërt në komunikim me fëmijët tuaj. Sapo fëmija juaj fillon të përdorë kompjuterin, telefonin celular ose ndonjë pajisje tjetër për tu kyçur në internet, prindërit duhet të bisedojnë me fëmijët e tyre

se si ata duhet të sillen dhe të komunikojnë në internet. Ju si prind, duhet të bisedoni me fëmijën tuaj lidhur me sigurinë në internet para se këtë ta bëjë dikush tjetër.

3. Krijoni një ambient të hapur dhe të përshtatshëm për bisedën me fëmijët

Fëmijët çdo herë presin ndihmë nga prindërit e tyre. Prandaj, bëhu mbështetës dhe pozitiv në këtë drejtim. Dëgjoni me vëmendje dhe durim kur ata flasin dhe keni parasysh ndjenjat e tyre. Bëhu i durueshëm. Shumica e fëmijëve kanë nevojë t'i dëgjojnë informatat apo këshillat tuaja disa herë. Komunikimi i hapur me fëmijët tuaj është mjaft i rëndësishëm. Mos reagoni ashpër kur fëmijët tuaj ndajnë përvojën e tyre me ju e sidomos nëse kuptoni se fëmija juaj ka bërë diçka të papërshtatshme gjatë përdorimit të internetit. Bisedoni rregullisht me fëmijët tuaj se si ata e përdorin internetin dhe me kë komunikojnë në internet. Inkurajoni fëmijët tuaj që t'ju tregojnë nëse diçka që hasin në internet i bën ata të ndjehen të kërcënuar ose të shqetësuar. Mësoni fëmijët tuaj se njerëzit gjatë komunikimit në internet, shpesh nuk janë në të vërtetë ata të cilët thonë se janë. Keqbërësit shpesh përdorin komunikimin në "chat" për të kontaktuar fëmijët dhe në shumë raste ata fshihen pas pseudonimeve të ndryshme. Falenderoni fëmijët tuaj për besimin që kanë ndaj teje dhe bindi ata se duhet të raportojnë abuzuesit.

4. Edukimi i fëmijëve

- Shpjegoju fëmijëve tuaj disa nga rregullat dhe udhëzimet më elementare lidhur me përdorimin e internetit. Është me rëndësi që fëmijët t'u përmbahen këtyre udhëzimeve dhe t'i ndajnë ato edhe me të tjerët.
- Edukoni fëmijët tuaj që të mos përgjigjen në mesazhe me gjuhë të vrazhdë dhe t'u shmangen bisedave online rreth çështjeve seksuale.
- Mësoni fëmijët tuaj që të mos hapin 'attachmente' ose linqe të faqeve

të internetit që mund të shfaqen gjatë bisedave në chat apo kur pranojnë ndonjë e-mail prej personave të panjohur.

- Inkurajoni fëmijët që të përdorin faqet e internetit vetëm për të komunikuar me miqtë e tyre dhe jo me njerëz të panjohur.
- Shpjegoju fëmijëve që asnjëherë të mos takohen me persona të panjohur, të cilët për herë të parë i kanë njohur vetëm në internet. Tregojni fëmijëve se njerëzit online mund të mos jenë ata që thonë se janë.
- Bindni fëmijët tuaj që të mos shpërndajnë të dhënat e tyre identifikuese personale. Ata duhet të kuptojnë se cilat informata duhet të mbahen private dhe jo të publikohen në profil të hapur. Inkurajoni fëmijët tuaj që të mos postojnë informata personale të tyre apo të miqve të tyre (si psh. fotografi, numrin e telefonit celular, adresat e shtëpisë, apo emrin e shkollës së tyre) në internet.
- Udhëzoni fëmijët tuaj që asnjëherë të mos përdorin web-kamerat në komunikim me persona të panjohur.
- Këshilloni ata që të mos postojnë në internet materiale pa miratimin tuaj.
- Shpjegoju fëmijëve se ajo çfarë ata shkruajnë në internet mund të lexohet nga kushdo tjetër.

5. Vendosni bashkë me fëmijën rregullat e përdorimit të internetit dhe të telefonit celular

Lista e rregullave duhet të përmbajë rregullat se si dhe kur fëmijët mundën ta përdorin internetin dhe telefonin. Disa nga rregullat mund të jenë temat si në vijim:

- Nëse fëmijët tuaj duhet apo nuk duhet të kenë akses në internet;
- Sa shpesh mund ta përdorin atë;
- Çfarë materiale mund të shkarkojnë;
- Si të sillen kur hasin në gjëra të papërshtatshme;

- Sa kohë mund të shpenzojnë në telefon;
- Kohën kur munden të përdorin internetin në telefon (p.sh. jo natën vonë).

6. Familjarizohu me faqet e internetit të përdorura nga fëmijët tuaj

- Familjarizohuni me atë se çfarë bëjnë fëmijët tuaj në internet dhe kontrolllo periodikisht faqet që fëmijët tuaj i vizitojnë.
- Prindërit duhet të dinë se si dhe për çfarë shërbejnë këto pajisje personale.

7. Rishikimi i karakteristikave të faqeve të internetit

- Rekomandohet që prindërit dhe mësuesit të diskutojnë me fëmijët lidhur me arsyet dhe nevojën e përdorimit të programeve monitoruese dhe mbajtjes së fshehtë të fjalëkalimit të këtij programi.
- Monitoro reklamat të cilat janë të papërshtatshme për fëmijët.
- Mbani kartat bankare të sigurta dhe mos zbuloni fjalëkalimin (PIN) e këtyre kartave. Keni parasysh se kur fëmijët fillojnë të blejnë në internet, gjasat rriten që ata të përdorin këto karta pa pëlqimin e prindërve.
- Sigurohu se bëhet verifikimi i moshës kur blihet ndonjë artikull apo shërbime nëpërmjet internetit.